

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

**MONITORIM MË EFIKAS I SISTEMIT GJYQËSOR NGA ILD DHE
BASHKËPUNIM ME ILDKPKI**





MONITORIM MË EFIKAS I SISTEMIT GJYQËSOR NGA ILD DHE BASHKËPUNIM ME ILDKPKI

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka hartuar një plan masash, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të efikasitetit të kontrollit të veprimtarisë së organeve të pushtetit gjyqësor, si dhe garantimin e një sistemi të drejtë e llogaridhënës ndaj magistratëve.

Në këtë kuadër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, znj. Evgjeni Bashari nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, në qëllimin e për-bashkët në forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korrupsionit e konfliktit të interesave, përmes shkëmbimit të informacionit mbi verifikimin e pasurisë, si dhe rastet e hasura në kushtet e konfliktit të interesave, të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve,

anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj të cilëve Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të funksioneve dhe kompetencave ligjore kryen verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor.

Në të njëjtën kohë, në aspekt të kryerjes së hetimeve disiplinore dhe inspektimeve institucionale e tematike, e më tej edhe në mungesë të një sistemi të aksesueshëm elektronik të teknologjisë së informacionit për organet e sistemit të drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson si mjet të rëndësishëm sigurimin e të dhënave periodike apo gjenerimin e raporteve statistikore e analitike, të aspekteve




të rëndësishme të funksionimit dhe administrimit të gjykatave dhe zyrave të prokurorive. Për këtë qëllim Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin për marrjen e informacionit periodik, çdo 6 muaj, prej datës 10 janar 2024, nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive në mbarë vendin, mbi gjendjen e faktike të volumit të punës, caktimit të çështjeve, kërkesat për heqje dorë, respektimit të afateve apo problematikave të ndryshme të konstatuara nga gjykatat dhe prokuroritë etj.

Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, e gjeni këtu linku: <https://ild.al/wp-content/uploads/2023/09/Marreveshje-bashkepunimi.pdf>

Urdhëri i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrjen e informacionit periodik nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive lidhur me

veprimtarinë gjyqësore dhe veprimtarinë e prokurorive, e gjeni këtu linku: <https://ild.al/wp-content/uploads/2023/09/Urdher-marrje-te->





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRITI BASHKËRAPORTUESIT E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani priti në një takim pune delegacionin e bashkëraportuesve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, që po zhvillojnë vizitën periodike faktmbledhëse në vendin tonë, të përbërë nga z. Asim Mollazada (Azerbajxhan, Grupi i Konservatorëve Europianë dhe Aleanca Demokratike) dhe z. Ionut Stroe (Rumani, Grupi i Partisë Popullore Evropiane), shoqëruar nga z. Bas Klein, Zëvendëskryetar i Sekretariatit, Komiteti i

Monitorimit dhe znj. Giulia Re, Shefe e Zyrës së KiE-së në Shqipëri.

Z. Metani bëri një prezantim të rolit dhe funksioneve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të punës e sfidave në 3 vite e gjysëm, që nga ngritja e institucionit më të ri të dalë nga reforma në drejtësi dhe punën për vendosjen e standardeve referuese ligjore për veprimtarinë e magjistratëve.

Z. Metani vlerësoi bashkëpunimin, që prej fillimit me Këshillin e Evropës, përmes projektit të Komisionit Evropian për Eficencën në Drejtësi, CEPEJ, për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



Inspektori i Lartë i Drejtësisë iu përgjigj interesit të raportuesve mbi aspekte të punës së institucionit dhe të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Z. Metani vlerësoi bashkëpunimin, që prej fillimit me Këshillin e Evropës, përmes pro-

jektit të Komisionit Evropian për Eficencën në Drejtësi, CEPEJ, për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës

zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për

***Gjatë muajit Shtator 2023,
Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve
me Publikun
ka pritur 34 ankues,
të cilët janë paraqitur në ambientet e
Zyrës së Inspektorit të Lartë të
Drejtësisë
dhe 23 telefonata me qytetarë,
të cilët kanë kërkuar informacion mbi
fazën e ankesave të tyre
ose Informacion mbi plotësimin e for-
mularit TIP të ankesës.***





ILD GJATE MUAJIT GUSHT

Edhe gjatë muajit gusht, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Arkiv-Protokollit, i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë ofruar shërbim të plotë për komunikimin me institucionin, pritjen e qytetarëve, asistimin e tyre në plotësimin e ankesave dhe kërkesave për informacion.

Pranë ambienteve të ILD-së gjatë muajit gusht janë asistuar dhe informuar 10 qytetarë, që janë paraqitur fizikisht, ndërsa përmes numrit të telefonit janë asistuar 8 qytetarë.

Gjatë muajit gusht, përmes postës elektronike dhe shërbimit postar janë paraqitur 15 kërkesa nga qytetarët, që kanë patur si objekt kërkesë për informacion mbi fazën ku ndodhet ankesa, kërkesë për takim, etj.

Po gjatë këtij muaji, nga zyra e Arkiv-Protokollit janë administruar 37 ankesa, nga të cilat 36 të depozituara nga qytetarët dhe 1 ankesë nga një institucion.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Shtator 2023**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **29 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuarit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKIM ME DELEGACIONIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR TË BULLGARISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani zhvilloi një takim me një delegacion të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Bullgarisë, që po zhvillon një vizitë pune në vendin tonë.

Delegacioni bullgar përbëhej nga dy anëtarë të Kolegjit të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Boyan Magdalinchev dhe znj. Tsvetinka Pashkunova dhe dy anëtarë të





Kolegjit të Prokurorëve pranë këtij Këshilli, është jo vetëm i rëndësishëm, por edhe i znj. Kalina Chapkanova dhe znj. Svetlana nevojshtëm. Boshnakova.

Pasi bëri një prezantim të institucionit që Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Bull-drejton, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vërejti garisë e njohën z. Metani me diskutimet për se shkëmbimi i përvojave mes institucioneve një reformë në sistemin e drejtësisë në





vendin e tyre dhe modele të ndryshme që po debatohen, përfshi edhe sistemin e inspektimit të magistratëve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë iu përgjigj interesimit të delegacionit të Bullgarisë, mbi aspekte specifike të institucionit dhe sistemit të drejtësisë, duke nënvizuar filozofinë e punës së Zyrës së ILD-së mbi vendosjen e balancës, mes interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe pavarësisë së magistratëve.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani magjistratëve prokurorë apo gjyqtarë, në zhvilloi një takim me kryetarin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. Roland Ilia, që sapo ka marrë detyrën. të KPK-së për verifikim ndaj veprimitarisë së magjistratëve.

Gjatë takimit, z. Metani dhe z. Ilia bashkëndanë vullnetin për vazhdimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, lidhur me nevojën reciproke për informacion të përditësuar, administrimin e informacionit për çdo vendimmarrje ndaj

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vuri në dukje se Zyra e ILD-së ka shqyrtuar çdo rast të përcjellë, me prioritet të lartë, duke kryer verifikimet e nevojshme.





NJË UNIFIKIM I LEGJISLACIONIT EUROPIAN KUNDËR KRIMIT MJEDISOR ËSHTË I DOMOSDOSHËM

Romë, 15 Shtator 2023

Inspektoratet e Drejtësisë të Italisë, Francës, Portugalisë, Rumanisë dhe Shqipërisë u mbledhën në Romë, nga data 13 deri më 15 Shtator, për takimin e radhës të programit studimor të projektit COPEIJ, të Komisionit Evropian, Bashkëpunimi për Mbrojtjen e mjedisit përmes Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë”, nën

kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë së Italisë dhe Inspektoratit të Përgjithshëm italian të Drejtësisë. Pjesëmarrësit u mikpritën e përshëndetën nga ministri i Drejtësisë z. Carlo Nordio e zv. Ministri i Drejtësisë z. Francesco Paolo Sisto, si dhe shefja e Inspektoratit të përgjithshëm të drejtësisë znj. Maria Rosaria Covelli, e cila kryesoi sesionet e tre ditëve të programit. Në përshëndetjen e tij,





ministri Nordio, theksoi nevojën që legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit, një nga të mirët e kohëve moderne, të bëhet homogjen dhe i balancuar për të gjitha vendet evropiane, natyrisht edhe duke ndërgjegjësuar opinionin publik përmes një komunikimi korrekt, adekuat dhe të plotë.

Eksperienca italiane në drejtim të luftës ndaj kimit mjedisor dhe përpjekjeve ligjore e institucionale për të koordinuar mbrojtjen e mjedisit, u përcoll përmes zyrtarëve të lartë të Ministrisë së

Ambientit dhe sigurisë energjetike, të Gjykatës së Kasacionit, të Prokurorit të Përgjithshëm e magistratë të antimafias, të Avokaturës së Shtetit, Këshillit të Shtetit, të Shkollës së Lartë të Magjistraturës, përfaqësues të botës akademike, të seksionit të karabinierisë, që merret me mbrojtjen e ambientit dhe të rojes bregdetare, Komisionerit të unifikuar për bonifikimin e landfillleve dhe shoqatës mjedisore “Legambiente”.

Ky cikël programesh studimore është pjesë e ak-





tiviteteve të Rrjetit Evropian të Shërbimit të Inspektiveve të Drejtësisë (RESIJ), pjesë e të cilit është me statusin e vëzhguesit,

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe si projekt mjedisor i financuar nga Komisioni Evropian, synon që vendet pjesëmarrëse të identifikojnë

çështje kritike dhe praktika të mira në fushën e krimeve mjedisore, për të hartuar më pas propozime dhe zgjidhje konkrete për përmirësimin e situatës mjedisore dhe bashkëpunimin në Evropë.



ILD në Twitter

← Post

Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...
@ILD_Albania

Follow

Në zbatim të funksioneve të ILD, me Inspektoren e Përgjithshme të ILDKPKI, 📩 një marrëveshje për shkëmbim të informacionit mbi verifikimin e pasurisë, si dhe rastet e hasura në kushtet e konfliktit të interesave, të magistratëve të të gjitha niveleve 📩 ild.al/sq/2023/09/12/...

Translate post



1:05 PM · Sep 12, 2023 · 85 Views

Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...
@ILD_Albania

Follow

Mbresues dokumentari “Revolta e Spaçit“ e studiueses Luljeta Progni rrëfyer nga protagonistët të kohës si një histori e jashtëzakonshme qëndrese e vitit '73. Urime të gjithëve që kontribuojnë për të sjellë dëshmi të tilla, si kujtesë se liria për shqiptarët ka patur kosto të lartë

Translate post



Kujto Albania Foundation

9:08 PM · Sep 20, 2023 · 104 Views

Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...
@ILD_Albania

Follow

Reflecting on an open justice agenda. It's a good path towards people-centered justice. Because justice must not only be done, but must also be seen to be done. #OGPEstonia2023 #HIJ 🇷🇺



9:18 AM · Sep 7, 2023 · 209 Views

Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...
@ILD_Albania

Follow

Një panoramë shumë frymëzuese, javën e kaluar, e përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit nga institucionet italiane. #COPEIJ 🇮🇹
#IspettoratoGeneraledellaGiustizia 🇮🇹 #RESIJ 🇪🇺
#ILD 🇷🇺 ild.al/sq/2023/09/15/...



1:43 PM · Sep 19, 2023 · 101 Views

SHTATORI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Shtator** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **36 ankesa**, të paraqitura nga qytetarët.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Shtator 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

9 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ 8 vendime verifikimi (praktika të ILD-së);
- ⇒ 1 vendim verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);
- ⇒ 2 ankesa (1 nga praktikat e ILD dhe 1 nga backlog) janë mbyllur me memo .

HETIME DISIPLINORE

2 vendim për fillim hetimi disiplinor për 2 magjistratë

1 vendim për vazhdim hetimi disiplinor për 2 magjistratë


ARKIVIME

107 vendime arkivimi nga 168 praktika të shqyrtuara (62 ankesa të bashkuara), konkretisht:

- ◆ 70 vendime arkivimi pas verifikimit nga praktika të ILD, nga të cilat:
 - ⇒ 50 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
 - ⇒ 20 vendime arkivimi pas verifikimit;
- ◆ 37 vendime arkivimi nga praktika të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD):
 - ⇒ 16 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
 - ⇒ 21 vendime arkivimi pas verifikimit.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Shtator** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **36 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë **313 shpallje publike**.

**INFORMACION**

Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit).

Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.

Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.

SHTATOR 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.


© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al


EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!